

VENDIM
Nr. 86, datë 4.3.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 62, DATË 6.9.2018, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME SARANDË SHA”**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”(VKM nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 4.3.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 62, datë 6.9.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Sarandë (UK Sarandë), me shkresat nr. 69 prot., datë 5.11.2020, me lëndë: “Kërkesë për ndryshim të zonës së shërbimit të UK Sarandë”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për ndryshim të zonës së shërbimit, dokumentacionin e nevojshëm mbi shkëputjen e njërive administrative Aliko, Finiq, Dhiver, Mesopotam të Bashkisë Finiq që më parë shërbeheshin nga UK Sarandë.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të ndryshimit të zonës së shërbimit të UK Sarandë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Sarandë me vendimin nr. 62, datë 6.9.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a.” me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit, si më poshtë:

Bashkia: Sarandë.

Bashkia: Finiq (pjesërisht)

Nj. Admin. Finiq, fshati Vrion;

Nj. Admin. Aliko, fshatrat Aliko, Çauth, Neohor, Tremul;

Nj. Admin. Dhiver, fshati Navaricë,

Nj. Admin. Mesopotam, fshatrat Livinë, Fitore, Krane, Ardhasovë.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Sarandë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 3, të vendimit të KKRR-së nr. 62, datë 6.9.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a.”, bëhen këto ndryshime:

Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Sarandë sh.a. është Bashkia Sarandë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani